

SHOQERIA "4A-M"SH.P.K.

Adresa" Rruga "Artan Lenja" Pallati i 4 A-M , Apartament A1, kati i I-rë  
Tirane

## **SHENIME SHPJEGUSE MBI PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE**

**Per ushtrimin e mbyllur me 31 dhjetor 2018**

### **1. Informacion mbi Shoqërinë**

Shoqeria „4 A - M“ shp.k. ,eshte krijuar me date 05.08.2009 . Ajo ushtron veprimtarine ekonomike ne perputhje me ligjin nr.9901. date 14.4.2008 „Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, dhe me Statutin e saj.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 148.478.830 leke.

Ortak i vetem i shoqerise;

1. Ardit Metaliaj me 100 % te aksioneve

Administrator i shoqerise eshte z. Ardit METALIAJ

Aktiviteti kryesor i kesaj shoqerie eshte, Punime & Instalime elektrike ,Tregtim imp-exp materialesh,Ndertim,Projektim i pakufizuar i veprave urbane dhe civile etj.

Shoqeria per vitin 2018 ka nje personel mesatar prej 236 punonjes.

### **2. Baza e përgatitjes**

Pasqyrat financiare përgatiten duke u bazuar në koston historike, me përjashtim të disa kategorive të aktiveve dhe detyrimeve, në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Keto standarte jane te detyrueshme ne baze te Urdhrit te Ministrise se Financave nr.65, dat e 25 maj 2008 “Per shpalljen dhe zbatimin e detyrueshem te Standardeve Ndwrkombwtare tw Kontabilitetit dhe te Raportimit Financiar, te perkthyer ne gjuhen shqipe.”

Shoqeria i mban te dhenat e kontabilitetit dhe i publikon pasyqrat financiare ne pajtueshmeri me ligjin mbi kontabilitetin nr. 9228, date 29 prill 2008 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

SHOQERIA "4A-M"SH.P.K.

Adresa" Rruga "Artan Lenja" Pallati i 4 A-M , Apartament A1, kati i I-rë  
Tirane

### **3. Gjykime të rëndësishme kontabël, vlerësime dhe supozime**

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që Drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto supozime.

Shoqeria kryen supozime dhe bën vlerësime të cilat kanë ndikim në shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Çmuarjet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazuar në eksperiencën e kaluar dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe parashikimet e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohet që janë të arësishme sipas rrethanave.

Gjykimet, vlerësimet dhe supozimet rishikohen në vazhdimësi. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar dhe në ato pasardhëse të ndikuara nga ky ndryshim. Në veçanti, informacioni mbi fushat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe gjykimeve të rëndësishme në aplikimin e politikave kontabël që kanë ndikimin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë përshkruar më poshtë.

#### ***Parimi i vijimësisë dhe krahasueshmëria***

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në parimin e vijueshmërisë.

Informacioni krahasues është paraqitur në përputhje me politikat kontabel që zbatohen nga Shoqëria. Janë bërë korigjimet e nevojshme për shifrat krahasuese në përputhje me ndryshimet në paraqitjet në periudhën aktuale.

#### ***Përcaktimi i vlerës së drejtë***

Nuk ka politika kontabël dhe dhënie informacionesh shpjeguese të rëndësishme të adoptuara nga Shoqëria, të cilat kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për aktivet dhe pasivet financiare dhe jo-financiare. Vlera e drejtë është përcaktuar për qëllime matjeje dhe/ose prezantimi bazuar në metodat në vijim. Supozimet në përcaktimin e vlerës së drejtë, kur janë të aplikueshme, prezantohen në shënimin përkatës.

#### **Tatimi mbi fitimin**

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi të ardhurat. Në përcaktimin e provizioneve të tatimit mbi të ardhurat janë të nevojshme çmuarjet. Ekzistojnë shumë transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar i tatimit është i pasigurtë gjatë

SHOQERIA “4A-M”SH.P.K.

Adresa” Rruga “Artan Lenja” Pallati i 4 A-M , Apartament A1, kati i I-rë  
Tirane

veprimtarisë normale të biznesit. Shoqeria njihet detyrimet për vlerësimet e organeve tatimore bazuar në vlerësimet nëse tatime të tjera shtesë do të lindin si detyrime. Nëse më pas ka diferencë midis detyrimit faktik dhe atij të regjistruar atëherë këto diferenca do të ndikojnë në tatimin mbi të ardhurat dhe provizionet për tatime në periudhën në të cilën është kryer ky krahasim.

#### **4. Përmbledhje e politikave bazë kontabël**

Polikat kontabël si më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në gjithë periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

##### ***(a) Transaksionet në monedha të huaja***

Regjistrimet kontabël të Shoqërisë përgatiten në Lekë, që është monedha kryesore e mjedisit ekonomik ku operon Shoqëria.

Transaksionet në monedhë të huaj regjistrohen në monedhën Lek, duke aplikuar mbi monedhën e huaj kursin e momentit të këmbimit të kësaj monedhe me Lek-un në datën e veprimit (kursi spot). Aktivitetet monetare dhe detyrimet në monedhë të huaj në datën e raportimit të pasqyrave financiare konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në atë datë. Diferencat e këmbimit që vijnë nga shlyerja/pagesa e mjeteve monetare ose nga konvertimi i mjeteve monetare me kurse këmbimi të ndryshme nga ato që janë përdorur në njohjen fillestare gjatë periudhës ushtrimore aktuale ose në pasqyrat financiare të mëparëshme, njihen si fitim ose humbje e periudhës ushtrimore kur ndodh diferenca. Mjetet jo-monetare që njihen me kosto historike në monedhë të huaj konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e veprimit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë janë të vlerësuara me kursin e këmbimit në datën kur vlera e drejtë është vendosur. Diferencat e këmbimit nga rivlerësimi në datën e bilancit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kurset e këmbimit më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 janë:

	<b>31 dhjetor 2018</b>	<b>31 dhjetor 2017</b>
Euro	123.42	132.95
USD	107.82	111.10

##### ***(b) Aktivitetet afatgjata materiale***

###### ***i) Njohja dhe matja***

SHOQERIA "4A-M"SH.P.K.

Adresa" Rruga "Artan Lenja" Pallati i 4 A-M , Apartament A1, kati i I-rë  
Tirane

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë, nëse ka. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kosto përfshin shpenzime që lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore (nëse ka), si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejtë me vënien e aktivit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar, si dhe kostot e çmontimit, largimit dhe restaurimit të vendit ku janë vendosur.

Programet kompjuterike të blera, të cilat janë pjesë përbërëse e funksionimit të pajisjes përkatëse, kapitalizohen si pjesë e saj.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

### ***ii) Kostot e mëpasshme***

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

### ***iii) Amortizimi***

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën zbritëse të amortizimit, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjesë të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

Nje ze i aktiveve afatgjata materiale c'regjistrohet kur nxirret jashte perdorimit apo shitet ose kur nuk priten perfitime ekonomike te ardhshme nga perdorimi ose shitja. Cdo fitim ose humbje qe rrjedh nga mosnjohja (c'regjistrimj) i aktivitet (llogaritur si